



Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry

## **TATIMI NË PRONË NË KOMUNAT E KOSOVËS**

Raport analitik mbi rëndësinë dhe suksesin e inkasimit të  
tatimit në pronë në komunat e Kosovës

Shkurt 2014



## PËRMBAJTJA

1. Hyrje .....	3
2. Metodologjia e grumbullimit të të dhënave .....	5
3. Faturimi dhe inkasimi i tatimit në pronë në vitin 2012, në 22 komuna të Republikës së Kosovës.....	6
3.1 Kontributi i të hyrave nga tatimi në pronë në buxhetin komunal.....	6
3.2 Përbërja e faturës së tatimit në pronë .....	7
3.3 Inkasimi total i tatimit në pronë.....	8
3.4 Shkalla reale e inkasimit të tatimit në pronë për vitin aktual .....	10
3.5 Inkasimi sipas kategorisë së pronës .....	11
3.6 Shkalla reale e inkasimit të tatimit në pronë për vitin aktual sipas kategorive të pronave .....	13
3.7 Analiza e numrit absolut të pronave të cilat paguajnë tatimin në pronë .....	14
4. Konkluzionet dhe rekomandimet .....	15

## 1. Hyrje

Raporti analitik mbi rëndësinë dhe suksesin e inkasimit të tatimit në pronë në komunat e Kosovës analizon situatën rreth tatimit në pronë në Kosovë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komunat e Kosovës. Ky raport është i bazuar në të dhënat e tatimit në pronë për vitin 2012, të cilat janë marrë nga komunat përkatëse dhe publikohet nga Lëvizja FOL.

Të hyrat vetanake të komunës rregullohen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVQL) i dekretuar në qershor të vitit 2008 si pjesë e pakos së ligjeve të propozimit gjithëpërfshirës të Ahtisaarit, dhe përkufizon financimin e komunës. Siç specifikohet në nenin 8 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, komunave duhet siguruar burime financiare që do të shfrytëzohen me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Në mesin e këtyre burimeve financiare janë ato që quhen të hyra vetanake (THV). Të hyrat vetanake të komunës krijohen nga tatimet komunale, taksat, ngarkesat dhe gjobat dhe përbëjnë 10-20% të financimit vjetor të komunave anekënd Kosovës. Më e rëndësishmja nga të gjitha këto të hyra vetanake është Tatimi në Pronë.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rreth 30% e pronave ekzistuese nuk janë të regjistruara. Në anën tjetër, sipas informatave nga komunat, gjatë viteve 2011-2012, janë bërë përpjekje të shtuara për t'i përfshirë të gjitha pronat e paregjistruara në sistemin e tatimit në pronë, por mendohet se një numër i konsiderueshëm i pronave vazhdojnë të jenë të paregjistruara, dhe të mos tatimohen. Ky është një problem serioz, duke e marrë parasysh faktin se vetëm një pjesë e qytetarëve e bartin barrën e pagesës së tatimit në pronë. Kur kësaj i shtohet edhe fakti se më pak se gjysma e shumës vjetore të faturuar paguhet, del se numri i qytetarëve të cilët e bartin barrën e pagesës së tatimit në pronë është akoma më i vogël.

Shkalla shumë e ulët e inkasimit të tatimit në pronë për vitin aktual paraqet një problem shumë serioz të akumulimit të borxheve të tatimit në pronë, të cilat komunat do ta kenë shumë veshtirë ta adresojnë në rast se nuk ndërrojnë trendet e inkasimit. Poashtu, bartja e barrës së tatimit në pronë nga vetëm rreth 40% e pronave të regjistruara dhe faturuara tregon për një sistem jo të drejte të tatimit në pronë në Kosovë.

Ky raport synon të analizojë situatën rreth tatimit në pronë në Komunat e Kosovës bazuar në të dhënat mbi tatimin në pronë të ofruara nga komunat e Kosovës e të nxjerra nga sistemi qendror i tatimit në pronë. Raporti fillimisht prezenton komunat të cilat kanë bashkëpunuar me Lëvizjen FOL dhe kanë ofruar të dhënat e tyre. Pastaj, raporti analizon në detaje në mënyrë të agreguar nivelin e faturimit të tatimit në pronë në vitin 2012, shkallën e inkasimit dhe përbërjen e mjeteve të inkasuara. Më tutje, raporti analizon shkallën e inkasimit dhe suksesin në menaxhimin dhe mbledhjen e tatimit në pronë në bazë të kategorive të pronave. Përfundimisht raporti jep edhe konkludimet kryesore dhe rekomandimet mbi përmirësimin e menaxhimit të tatimit në pronë.

Pasqyra e suksesit të komunave të Kosovës në menaxhimin dhe inkasimin e tatimit në pronë e paraqitur më poshtë në këtë raport tregon për një situatë jo të favorshme, e cila kërkon vëmendje dhe angazhim më të madh të komunave të Kosovës, por edhe të tatimpaguesve të rregullt.

## 2. Metodologjia e grumbullimit të të dhënave

Bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, neni 4, 5 dhe 6 dhe në Ligjin për Tatimin në Pronat e Paluajtshme, Lëvizja FOL u ka dërguar kërkesë për qasje në të dhënat e tatimit në pronë 34 komunave të Republikës së Kosovës.

Lëvizja FOL dëshiron të falenderojë të gjitha komunat e Kosovës të cilat kanë bashkëpunuar në sigurimin e të dhënave për këtë raport. Raporti është i bazuar në raportet e gjeneruara nga sistemi i tatimit në pronë, përkatësisht Raportet mbi Ngarkesën dhe Inkasimin e Tatimit në Pronë, të gjeneruara nga të gjitha komunat bashkëpunuese. Raporti është përpiluar në bazë të të dhënave të ofruara nga komunat e paraqitura në tabelën më poshtë:

Komunat të cilat kanë ofruar të dhënat e tatimit në pronë
DRAGASH
FUSHË KOSOVË
GJAKOVË
GJILAN
GLLOGOC
GRACANICË
HANI I ELEZIT
ISTOG
JUNIK
KAÇANIK
KAMENICË
MALISHEVË
MITROVICË
NOVOBËRDË
OBILIQ
PEJË

PRISHTINË
RANILLUG
SHTIME
SUHAREKË
VITI
VUSHTRRI

Poashtu, komuna e Rahovecit, Skënderajt, Ferizajt dhe Podujevës kanë ofruar të dhënat mbi tatimin në pronë, mirëpo këto të dhëna nuk kanë qenë në formatin e kërkuar për analizë më të thellë dhe si të tilla nuk janë përdorur në këtë raport. Për këtë arsye, raporti është i bazuar në të dhënat e ofruara nga 22 nga 34 komunat e Kosovës të cilave i'u është drejtuar kërkesa dhe atë në të dhënat e vitit 2012.

### 3. Faturimi dhe inkasimi i tatimit në pronë në vitin 2012, në 22 komuna të Republikës së Kosovës

#### 3.1 Kontributi i të hyrave nga tatimi në pronë në buxhetin komunal

Komunat në bazë të Ligjit për financat e pushtetit lokal (LFPL) mund të ngrisin të hyrat vetanake kryesisht përmes ngarkimit të taksave për shërbimet komunale, të hyra të cilat mbahen brenda komunës. Tatimi në pronë është tatimi i vetëm të cilin komunat mund ta inkasojnë ligjërisht dhe të ngrisin të hyrat e përgjithshme, të cilat mund të shpenzohen përmes projekteve të cilat vendosen nga vet komuna. Në kuptim të madhësisë, të hyrat vetanake historikisht përbënin rreth 17% të të hyrave totale komunale në çdo vit. Brenda të hyrave vetanake, tatimi në pronë është më i rëndësishmi që zë rreth 30% të të hyrave vetanake dhe në mesatare për vitin 2012, tatimi në pronë i faturuar përbën rreth 4% të buxhetit total të komunave të analizuar.


Duke u bazuar në të dhënat e pranuar nga komunat si dhe buxhetet komunale për vitin 2012, tabela më poshtë paraqet rëndësinë e tatimit në pronë për komunat e Kosovës.

Komunat të cilat kanë ofruar të dhënat mbi tatimin në pronë	Buxheti i Rishikuar 2012	Tatimi në pronë i Faturuar për vitin 2012	TP si përqindje e Buxhetit Komunal
DRAGASH	€ 5,547,372.00	€ 182,524.72	3.29%
FUSHË KOSOVË	€ 6,091,949.00	€ 387,427.75	6.36%
GJAKOVË	€ 18,342,716.00	€ 971,203.09	5.29%
GJILAN	€ 18,162,902.00	€ 1,046,454.51	5.76%
GLLOGOC	€ 9,820,501.00	€ 227,118.36	2.31%
GRACANICË	€ 5,578,470.00	€ 349,994.70	6.27%
HANI I ELEZIT	€ 1,686,726.00	€ 71,917.70	4.26%
ISTOG	€ 7,561,792.00	€ 270,764.56	3.58%
JUNIK	€ 1,398,572.00	€ 32,272.96	2.31%
KAÇANIK	€ 5,457,755.00	€ 227,354.16	4.17%
KAMENICË	€ 7,148,704.00	€ 204,789.76	2.86%
MALISHEVË	€ 9,964,410.00	€ 242,209.85	2.43%
MITROVICË	€ 17,153,984.00	€ 465,236.08	2.71%
NOVOBËRDË	€ 2,279,090.00	€ 45,612.34	2.00%
OBILIQ	€ 4,388,983.00	€ 244,361.15	5.57%
PEJË	€ 18,254,846.00	€ 1,148,488.95	6.29%
PRISHTINË	€ 61,741,684.00	€ 4,471,595.82	7.24%
RANILLUG	€ 1,090,365.00	€ 21,277.88	1.95%
SHTIME	€ 4,713,956.00	€ 100,535.98	2.13%
SUHAREKË	€ 12,306,484.00	€ 574,501.94	4.67%
VITI	€ 8,065,064.00	€ 186,102.50	2.31%
VUSHTRRI	€ 12,612,512.00	€ 363,323.47	2.88%

### 3.2 Përbërja e faturës së tatimit në pronë

Sa i përket përbërjes së faturës së tatimit në pronë, në bazë të të dhënave të ofruara për vitin 2012 nga 22 komunat të cilat për analizën e këtij raporti i kanë dërguar të dhënat e plota mbi tatimin në pronë, 80% e vlerës së faturuar në faturat për tatim në pronë për vitin 2012 ka të bëjë me vlerën e tatimit në pronë për vitin përkatës. Pjesa e mbetur përfshin faturimin e kamatave për vonesat për vitet paraprake (15% e vlerës totale të faturuar) dhe me faturimin e dënimeve për mospagesë me kohë të kësteve të tatimit në pronë për vitet paraprake (5% e vlerës totale të faturuar ne vitin 2012).


<u>Faturimi i TP për vitin 2012</u>	€11,835,059.31
<u>Faturimi i dënimeve për vitet paraprake</u>	€ 702,827.93
<u>Faturimii kamatës për vitet paraprake</u>	€ 2,198,833.86



### 3.3 Inkasimi total i tatimit në pronë

Për të pasur një analizë më të saktë të shkallës së pagesës së tatimit në pronë, është e nevojshme të bëhet përllogaritja vetëm e pagesës së tatimit në pronë për vitin aktual. Ky është tregues i shkallës së pagesës së rregullt të tatimit në pronë.

Nëse analizohen vlerat totale të faturuara për vitin 2012 (përfshirë tatimin në pronë si dhe interesin e dënimeve për vitet paraprake) si dhe shumën totale të inkasuar në emër të tatimit në pronë gjatë vitit 2012 në komunat e analizuara në këtë raport, shihet se inkasimi total përbën rreth 69.22% të vlerës totale të faturuar. Ashtu që, nga vlera totale e faturuar nga këto 22 komuna prej 14,736,721 Euro, gjithsej janë mbledhur 10,201,240 Euro. Mirëpo, kjo pasqyrë është paksa e shtrembëruar, pasi në këtë inkasim përfshihen të gjitha inkasimet ku bëjnë pjesë edhe inkasimet e borxheve të vjetra, inkasimet e dënimeve dhe kamatave.




Për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth përbërjes së inkasimit, vlera totale të inkasuar është zbrëthyer në përbërësit e saj si vijon:

Paguar për TP 2012	€ 5,330,840.10
Paguar për borgje të vjetra	€ 3,834,357.79
Paguar për kamata	€ 734,409.19
Paguar për dënime	€ 301,633.15




Nga këtu shihet, se vetëm 52% e shumës së inkasuar ka të bëjë me pagesën e tatimit në pronë për vitin aktual (2012), ndërsa 48% e pagesave të inkasuara nga komunat në emër të tatimit në pronë kanë të bëjnë me pagesa të borxheve të vjetra (38%), pagesë të kamatave për vonesa (7%) si dhe dënimeve për tajkalim e afateve ligjore për pagesë (3%).



### 3.4 Shkalla reale e inkasimit të tatimit në pronë për vitin aktual

Në qoftë se analizojmë inkasimin e tatimit në pronë për vitin aktual, që edhe do të duhej të konsiderohet si shkalla e vërtete e inkasimit të tatimit në pronë (pasi kjo paraqet shkallën e pagesës së tatimit në pronë të faturuar për një vit përkatës), bazuar në të dhënat e 22 komunave, shohim se vetëm 45% e tatimit në pronë të faturuar për vitin 2012 është inkasuar nga komunat e analizuar. Kjo paraqet një çështje shumë të rëndësishme, pasi një shkallë e inkasimit nën 50% të vlerës së tatimit në pronë të faturuar për një vit përkatës do të thotë se borxhet totale për tatimin në pronë çdo vit rriten për mbi 50% të vlerës së faturuar. Më tutje, një shkallë e tillë e mos pagesës nënkupton që edhe kamatat ndëshkuese për mospagesë si dhe dënimet e përlogaritura për shkak të tejkalimeve të afateve ligjore për pagesë në përgjithësi i ngarkojnë edhe më shumë tatim paguesit, derisa në të njëjtën kohë shkaktojnë një problem serioz për komunat dhe mundësitë e tyre për inkasim në të ardhmen.



Nga 11,835,059 Euro të faturuara nga këto 22 komuna në emër të tatimit në pronë për vitin aktual, vetëm 5,330,840 Euro janë mbledhur.

### 3.5 Inkasimi sipas kategorisë së pronës

Për të analizuar burimet e problemeve rreth pagesës së tatimit në pronë, tabela në vijim paraqet gjithsej faturimet dhe inkasimet sipas kategorive të pronave (të grupuara në dy super kategori), ato rezidenciale dhe komerciale. Në pronat rezidenciale përfshihen të gjitha pronat për banim, ato të liruara nga tatimi, pronat e paklasifikueshme, të papërfunduara, të përjashtuara, të braktisura, garazhet dhe të vazhduara. Ndërsa, në prona komerciale janë llogaritur të gjitha pronat që klasifikohen për shfrytëzim komercial, përfshirë edhe pronat industriale dhe të industrisë së përpunimit, pronat bujqësore, ato për rekreacion, shërbime, transport si dhe pronat sociale, kulturore dhe institucionale.

Nga të dhënat e paraqitura më poshtë për 22 komunat e analizuara, del se shkalla nominale e inkasimit është më e mirë te pronat rezidenciale (74.13%) se sa te ato komerciale (63.29%). Kjo tregon se komunat duhet të bëjnë më shumë për të shtuar inkasimin nga pronat komerciale, të cilat për nga numri absolut janë më të vogla në numër dhe është më lehtë të targetohen dhe të ndjeken aktivisht për inkasim.


	Total Fatura sipas kategorive	Total pagesat në emër të TP	Shkalla nominale e inkasimit
Prona rezidenciale	€ 8,062,112.91	€ 5,978,695.46	74.13%
Prona komerciale	€ 6,671,608.20	€ 422,544.86	63.29%

Për të parë me saktësisht përbërësit e vlerës totale të inkasuar gjatë vitit 2012 sipas kategorive të pronave në 22 komunat e analizuara, tabela më poshtë paraqet të dhëna interesante. Inkasimi nga **pronat rezidenciale** tregon se nga total inkasimi, rreth **46% është pagesë e faturës së vitit aktual**, ndërsa **pjesa e mbetur** (rreth 54%) ka të bëjë me inkasimin e borxheve të vjetra, kamatave dhe dënimeve.

Pasqyra për pronat komerciale dallon pak, ku **61% e inkasimit total ndërlidhet me pagesa të tatimit në pronë për vitin aktual**, ndërsa **39% janë te ndërlidhura me pagesa për borxhe të vjetra, kamata dhe dënime**. Mirëpo, **vlera e inkasimit të tatimit për vitin aktual (inkasimi real)** të të dy kategoritë e pronave është nën 50% të vlerës së faturuar, siç është paraqitur në seksionin e ardhshëm të këtij raporti.


	Vlera e paguar për tatimin e vitit aktual	Pagesat e borxheve të vjetra	Pagesat për kamata	Pagesat për dënime
<b>Pronat rezidenciale</b>	€ 2,739,073.65	€ 2,549,383.65	€ 499,443.59	€ 190,794.57
	45.81%	42.64%	8.35%	3.19%
<b>Pronat komerciale</b>	€ 2,591,766.54	€ 1,284,974.14	€ 234,965.60	€ 110,838.58
	62%	30%	6%	3%

### Përbërësit e vlerës së inkasuar në prona rezidenciale



■ Vlera e pagua për tatimi e vitit aktual ■ Pagesat e borxheve të vjetra  
 ■ Pagesat për kamata ■ Pagesat për dënime

### Përbërësit e vlerës së inkasuar në prona komerciale



■ Vlera e pagua për tatimi e vitit aktual ■ Pagesat e borxheve të vjetra  
 ■ Pagesat për kamata ■ Pagesat për dënime

### 3.6 Shkalla reale e inkasimit të tatimit në pronë për vitin aktual sipas kategorive të pronave

Për të analizuar shkallën reale të inkasimit të tatimit në pronë, sipas kategorisë së pronës, tabela më poshtë analizon inkasimin e tatimit në pronë për vitin aktual. Të dhënat e 22 komunave të analizuar tregojnë se shkalla reale e inkasimit të tatimit në pronë për vitin aktual në pronat rezidenciale është 42.87%, ndërsa shkalla reale e inkasimit për pronat komerciale në vitin 2012 është 47.60%.

	Tatimi në pronë i faturuar për vitin 2012	Inkasimi real i tatimit në pronë për vitin 2012	%
Pronat rezidenciale	€ 6,389,935.74	€ 2,739,073.65	42.87%
Pronat komerciale	€ 5,445,123.57	€ 2,591,766.54	47.60%

### 3.7 Analiza e numrit absolut të pronave të cilat paguajnë tatimin në pronë

Për të analizuar shkallën e suksesit të tatimit në pronë në komunat e Kosovës si dhe për të analizuar barabarësinë në zbatimin e tatimit në pronë, ky raport analizon edhe shkallën e suksesit duke krahasuar numrin e pronave të cilat kanë pranuar faturën e tatimit në pronë dhe kanë paguar së paku 1 Euro në emër të tatimit në pronë. Kjo pasqyrë shërben për të parë se sa është në fakt numri i pronave të cilat janë faturuar për tatim në pronë, mirëpo të cilat nuk kanë paguar asgjë - gjë që tregon shkallën e shpërndarjes së barrës së tatimit në pronë në 22 komunat e analizuara.

Nr. i pronave të faturuar në vitin 2012	288,709	
Nr. i pronave që paguajnë së paku pjesërisht faturën e tatimit në pronë	115,777	31.65%

Nga kjo tabelë shihet, se nga gjithsej 288,709 prona të faturuara për tatim në pronë (në komunat e analizuara për këtë raport), mund të shihet se proporcioni i pronave të cilat kanë paguar në emër të tatimit në pronë së paku pjesërisht (mbi zero euro) është vetëm 115,777 prona, apo pak nën 32% të pronave të cilat janë faturuar. Kjo tregon se si pasojë e mosmenaxhimit adekuat të tatimit në pronë nga komunat e Kosovës, rreth 68% e pronave të regjistruara dhe faturuara nuk paguajnë asgjë në emër të tatimit në pronë. Kjo përsëri vë në pah shpërndarjen drastikisht të pabarabartë të të hyrave dhe barrës së tatimit në pronë.

Për të parë një pasqyrë edhe më të qartë të kësaj shpërndarjeje, tabela më poshtë paraqet numrin e pronave që paguajnë tatimin në pronë sipas kategorive të klasifikimit (residenciale dhe komerciale).

Nr. i pronave rezidenciale të faturuar në vitin 2012	243,436	
Nr. i pronave rezidenciale që paguajnë së paku pjesërisht faturën e tatimit në pronë	98,209	40.51%

Nr. i pronave komerciale të faturuar në vitin 2012	46,273	
Nr. i pronave komerciale që paguajnë së paku pjesërisht faturën e tatimit në pronë	17,568	37.97%

Nga të dhënat e mësipërme shihet se vetëm rreth 40% të pronave rezidenciale kontribuojnë në vlerën e tatimit në pronë të mbledhur nga pronat me karakter rezidencial. Tek pronat komerciale, situata është edhe më e rëndë, ku vetëm 38% e pronave komerciale bartin barrën e tatimit në qira të inkasuar në vitin 2012 në 22 komunat e analizuara.

#### 4. Konkluzionet dhe rekomandimet

---

Pasqyra e suksesit të komunave të Kosovës në menaxhimin dhe inkasimin e tatimit në pronë e paraqitur më sipër në këtë raport tregon për një situatë jo të favorshme, e cila kërkon vëmendje dhe angazhim më të madh të komunave të Kosovës.

Shkalla shumë e ulët e inkasimit të tatimit në pronë për vitin aktual paraqet një problem shumë serioz të akumulimit të borxheve të tatimit në pronë, të cilët komunat do ta kenë shumë vështirë ta adresojnë në rast se nuk ndërrojnë trendet e inkasimit. Po ashtu, bartja e barrës së tatimit në pronë nga vetëm rreth 40% e pronave të regjistruara dhe faturuara tregon për një sistem jo të drejtë të tatimit në pronë në Kosovë.

Duke e marr parasysh rëndësinë e tatimit në pronë për komunat e Kosovës, si dhe pritjet që ky tatim të fitojë edhe me ne rëndësi, si dhe me qëllim për të përmirësuar situatën aktuale, komunat e Kosovës duhet të inkurajohen për angazhim më të madh në menaxhimin e mirëfilltë të tatimit në pronë. Në bazë të kornizës ligjore në Kosovë si dhe në bazë të përvojave në disa komuna, rekomandohet që komunat të ndërmarrin një sërë masash për përmirësimin e situatës. Më poshtë janë të paraqitura disa nga këto masa të rekomanduara:

- Regjistrimi i rregullt i pronave të reja dhe atyre ekzistuese por të paregjistruara;
- Ushtrimi rigoroz i masave për realizimin e Vjeljes dhe Vjeljes së detyruar të Tatimit në Pronë (të gjitha masat e parapara me Udhëzim Administrativ deri te konfiskimi i aseteve dhe palujtshmërive);
- Krijimi i sistemit për monitorim të mirëfilltë dhe të vazhdueshëm në baza javore apo mujore të performancës / shkallës së inkasimit;
- Zbatimi strikt i masave të kushtëzimit me pagesën e tatimit në pronë;
- Sigurimi i burimeve njerëzore dhe teknologjike për Njësinë Komunale të Tatimit në Pronë;
- Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve për stafin e Njësisë së Tatimit në Pronë;
- Komunikimi dhe Marrëdhëniet me Publikun, përfshi fushata të marrëdhënieve publike për të rritur gatishmërinë e qytetarëve për të paguar;

Komunat e Kosovës duhet të inkurajohen dhe shtyhen që të ndërmarrin disa apo të gjitha masat e rekomanduara me qëllim të përmirësimit të inkasimit të tatimit në pronë.

## Falënderime

Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në ueb faqen zyrtare: [www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

## Rreth Lëvizjes FOL

Misioni i Organizatës është të mbështes qytetarinë aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit dhe formave tjera të keqpërdorimit të autoritetit publik. Për të përmbushur misionin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.